REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 12 / 07 / 2024
Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera
01- 060104-33348

Republika e Kosovës
Republika Kosova–Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas–Municipality of Drenas

# PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR DRAFT-STRATEGJINË PËR ZHVILLIMIN DHE FUQIZIMIN E TË RINJËVE NË KOMUNËN E DRENASIT 2024-2029



KOMUNA E DRENASIT

10/07/2024

## INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Drenasit(Gllogocit) 01 Nr.110-6904 dhe Nenit 19 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Komuna e Drenasit/Gllogocit, bën njoftimin për :

**KONSULTIM PUBLIK PËR DRAFT-STRATEGJINË PËR ZHVILLIMIN DHE FUQIZIMIN E TË RINJËVE NË KOMUNËN E DRENASIT 2024-2029**

Njoftimi për qytetarë për organizimin e konsultimit publik është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik

Publikimi i këtij dokumenti për konsultim publik u bë me datë 31.05.2024 i cili ishte i hapur për sugjerime dhe rekomandime deri më 18.06.2024;

Në ueb-faqe zyrtare të komunës:

https://kk.rks-gov.net/.../category/konsultimet-publike-al/

Në facebook-un e komunës:

https://www.facebook.com/komunadrenas, si dhe

Në platformën e konsultimeve publike:

https://konsultimet.rks-gov.net/meetingsList.php

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Komuna e Drenasit**
**Opština Drenas-Municipality of Drenas**
01 Nr. 070/03-26016 datë 31/05/2024

Duke u bazuar ne Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), 01 Nr.110-6904 dhe Nenit 19 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Komuna e Drenasit/Gllogocit lëshon këtë:

## NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Draft –Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e të rinjve 2024-2029:

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data **31.05.2024** deri me datën **18.06.2024**, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me datë **13.06.2024** në Sallën e Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora **10:00**.

Komentet dhe sugjerimet tuaja, mund t'i dërgoni deri më datë **18.06.2024** në ora **16:00** në këto adresa; enkela.dema@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net

Për më shumë detaje në lidhje me Draft –Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e të rinjve 2024-2029 vizitoni vegezat e mëposhtme ku është publikuar ky draft dokument;

Ueb faqja zyrtare e Komunës në rubrikën Konsultimet Publike, në këtë link:

https://kk.rks-gov.net/gllogoc/category/konsultimet-publike-al/

Platforma për Konsultime Publike:

https://konsultimet.rks-gov.net/meetingsList.php

Rrjetin social të Facebook:

https://www.facebook.com/komunadrenas

**Bekim Dobra**

**Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun**

## KONSULTIMI PUBLIK

Konsultimi publik me qytetarë u mbajt me datë 13.06.2024 në Sallën e Kuvendit të Komunës, dhe filloi në ora 10:00.

Konsultimi publik me qytetarë u organizua nga Komisioni Komunal për Draft-Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e të rinjëve në Komunën e Drenasit 2024-2029, i përbërë nga:

1. **Bekim Dobra-** Udhëheqës i njësisë për Komunikim me Publikun;
2. **Laureta Thaqi-** Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme- kryetare e komisionit (ALUMNI);
3. **Qëndrim Hoxha-** LDA Ballkan- anëtarë i grupit punues; dhe
4. **Enkela Dema-**Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport- anëtare e grupit Punues;

Hapja e konsultimit publik u bë nga **Bekim Dobra,** Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun në Komunën e Drenasit.

Fillimisht, **z. Dobra**, falënderoj pjesëmarrësit dhe theksoi se:

Sot jemi këtu para jush për të prezantuar dhe diskutuar një nga iniciativat më të rëndësishme për të ardhmen e të rinjëve Komunës tonë - Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e të Rinjve.

Për këtë arsye Përmes kësaj draft strategjie synojmë krijimin e një mjedisi të favorshëm për të rinjtë tanë, duke u ofruar atyre mundësi të reja për zhvillim, arsimim, punësim dhe gjithëpërfshirje që të rinjtë tanë të kenë të gjitha mjetet, mundësitë dhe mbështetjen e nevojshme për të arritur potencialin e tyre të plotë në zhvillimin e ideve dhe qëllimeve, përgatitjen e një brezi të ri të aftë dhe të angazhuar për të marrë pjesë aktive në zhvillimin ekonomik, social dhe politik të vendit duke kontribuar në mënyrë pozitive në zhvillimin e kapaciteteve, ndërtimin e një mundësie për rininë të jenë pjesë aktive në shoqëri në të gjitha proceset vendimmarrëse

Draft Strategjia është dokument strategjik komunal, i hartuar në pajtim me orientimet e përcaktuara nga Strategjitë për Vetëqeverisje lokale dhe aktet juridike përcjellëse të nivelit qendror që promovojnë qeverisjen transparente.

Me plan të kësaj draftstrategjie, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standardet, parimet, objektivat, metodat dhe mjetet efektive duke ndjekur një qasje të strukturuar që kjo strategji të ketë një ndikim të qëndrueshëm dhe pozitiv në përmirësimin e jetës së tyre.

Zhvillimi dhe fuqizimi i të rinjve është një investim kyç për të ardhmen e shoqërisë. Kjo strategji përfaqëson një angazhim të qartë për të krijuar një mjedis ku të rinjtë mund të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në zhvillimin e vendit. Për këtë arsye, zotohemi që Komuna e Drenasit me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin do të rris gatishmërinë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha kërkesave të të rinjëve për të qenë të angazhuar aktivisht në planifikimin dhe zhvillimin e politikave, për të siguruar që efektet e zbatimit të tyre të japin rezultatet e dëshiruara dhe afektojnë direkt interesin e përgjithshëm të rinisë.

Për fund, këtë dokument e kemi ndarë me të gjithë qytetarët e Komunës pasi që ky dokument është i publikuar edhe në ueb-faqen e Komunës, në rrjetet sociale të Komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike. Dhe, pres nga ju që edhe sot ta merrni fjalën, duke dhënë kontributin tuaj me sugjerime dhe rekomandime.

Kryesuesi i Konsultimit Publik **Bekim Dobra** i jep fjalën **Qëndrim Hoxha**

Të nderuar pjesëmarrës të këtij konsultimi Publik është nder dhe privilegj që të jem pjesë e grupit punues të këtij draft dokumenti shumë të rëndësishëm për të rinjët e Komunës së Drenasit, ku ne nuk hartuam thjeshtë një dokument, por krijuam një vizion për të ardhmen. Një të ardhme ku të rinjt e Drenasit janë në qendër të zhvillimit. Ndër të tjera shpreh falënderime të veçanta për secilin anëtarë të ekipës punuese në Drenas të cilët janë angazhuar gjatë gjithë procesit të hartimit të këtyre dokumenteve dhe të gjithë të rinjtë e përfshirë në projekt.

Kjo strategji është hartuar në kuadër të projektit "Angazhimi i të rinjve, një Zë për Ndikim", i financuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së përmes programit "Alumni Engagement Innovation Fund 2023", mbështetur nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë, administruar nga KUSA dhe zbatuar nga dy anëtarë të Alumni, **Xhemile Murati - Shabani** dhe **Laureta Thaqi** në bashkëpunim me organizatën Qendra për Avokim dhe Angazhim Qytetarë AdVOICE të cilat i falënderoj për besimin dhe bashkëpunimin gjatë gjithë këtyre muajve. Uroj që këto dokumente të gjejnë zbatim në praktik, viteve në vijim gjithmonë në shërbim të kauzës së fuqizimit të rinisë në Drenas! Faleminderit për mirëpritjen bashkëpuntorëve të Komunës së Drenasit, znj.Laureta Thaqi znj.Enkela Dema si dhe të gjithë grupit punues për bashkëpunimin, miqëve të vjetër e të rinj në Drenas!

**Bekim Dobra-** Hap Debadin për Komente, Fjala është për ju, por paraprakisht para se të merrni fjalën, lus që të prezantoheni për arsye të evidentimit të secilës kërkesë.

Faleminderit paraprakisht.

**Laureta Thaqi-** Shfrytëzoj rastin të falenderoj **KUSA"Fjollen dhe Viktorin"** për mbështetjen në realizimin e këtij projekti dhe qka do që kem pas në bashkëpunim me ju kemi ofruar zgjidhje, na ktu shumica e antarëve të rinjëve janë pjesë e grupit punues për DraftStrategjinë janë nga këshilli i nxënësve dhe organizata të tjera, njoftimi është bërë sipas afatit ligjor prej 15 ditësh dhe përveq këtij takimi publik që ka mundësi me dhanë komente, ka mundësi të jepen komente deri më datën 18 Qershor në formë elektronike dhe fizike në Objektin e Komunës së Drenasit me i paraqit kërkesat e tyre, DraftStrategjia është publikuar me kohë në webfaqen e Komunës së Drenasit përveq që e kemi shfrytëzuar webfaqen kemi vendos njoftime edhe në hyrje të Objektit të Komunës si dhe në tabelën njoftuese në oborrin e Komunës, po ashtu kemi njoftuar të rinjët përmes Këshillit të nxënësve dhe Këshillit të prindërve, dhe qka do që keni ne jemi të gatshëm me diskutu bashkë dhe qfarëdo komenti, apo rekomandim sugjerim me përfshi në strategji ju faleminderit shumë.

**Lendita Elshani-** Përfaqëuese e OJQ-Handikos Drenas unë si anëtare e grupit punues kam parë planin ku disa shuma të cekuara mendoj që janë shuma të vogla për Organizatat kan mundsi me apliku, edhe pse kjo është shuma që Komuna ka mundësi përkrahje por mendoj që në të ardhmen kur Komuna ka mundësi bashkëpunimi Organizatat e jashtme kur të shohin këto shuma të vogla

nuk është e mirë se ata kanë mundësi më të mëdha të përkrahjes dhe pse mos të kemi mundësi të përfitimit më të mëdha të fondeve nga ana e tyre.

**Qëndrim Hoxha**-Ju falenderojmë për komentin, e kemi diskutuar edhe ne takimet me grupet punuese që Komuna e Drenasit si dhe Komunat tjera të Republikës së Kosovës nuk e kanë Buxhetin e mjaftueshëm për të mbuluar Aktivitete Rinore dhe kërkesat që vijn ka raste që shuma e mbështetjes është më e vogël se minimumi e shumës sipas thirrjes për ta bërë shprëndarjen në mes të aplikuesve dhe kjo mendoj që ja hup cilësinë edhe projekteve, tek plani i veprimit mund të rekomandojmë që kjo është pjesa që mund ta mbështesë Komuna që shuma e vendosur është mbi bazën e fondeve që mund ta mbështesë Komuna dhe pjesa tjetër mund të mbështetet nga Organizatat apo Donatorët tjerë, dhe duhet të plotësohen Deklarata për Financim të Dyfishtë dhe në Aplikacion. Kjo është e mirë sepse vlerat e cekura në strategji janë të vendosura mbi bazën që mund të ofroj Komuna dhe me anë të Bashkëfinancimit mund të plotësohet edhe pjesa e tjetër e projektit nga Ministritë, Organizatat e ndryshme siq janë, Gizi Gjerman etj.

**Doruntina Gashi** nga **HUMANUSVITA**- Jam e lumtur për këtë Dokument Strategji që është shumë i rëndësishëm dhe që jam pjesë e grupit punues të kësaj Strategjie dhe që Komuna na ka ftuar si OJQ që ka qenë shumë e rëndësishëm rrjetizimi dhe bashkëpunimi si dhe me këtë Strategji si bazë e fortë bashkëpunimi, ju faleminderit të gjithve për bashkëpunimin.

**Bekim Dobra-Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun në Komunën e Drenasit** Faleminderit për komentet dhe sugjerimet tuaja. Deshta të rikujtoj që afati ligjor për pranimin e komenteve në formë elektronike është deri më datën 18 Qershor para se i njëjti të miratohet në Mbledhjen e Kuvendit dhe do të pregaditet dokumenti nga grupi punues dhe të merr formen finale pas shyrtimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe të jetë në ekzekutim. Faleminderit për pjesëmarrjen.

Konsultimi publik me qytetarë përfundoi në orën 11:00.

nk | Sweep Move to Categories ••• Undo

# Komentet dhe rekomandimet e Demokraci Plus (D+) në draft strategjinë për zhvillimin dhe fuqizimin e rininë në Komunën e Drenasit 2024 - 2029

Democracy Plus <info@dplus-ks.org>
Fri 6/14/2024 2:37 PM
To: Enkela Dema
Cc: Komuna Drenas; Bekim Dobra; Visar Rushiti <visar@dplus.org>; Liridon Elshani <liridon@dplus.org>; Valmir Ismaili <valmir@dplus.org>

Reply all

Inbox

To help protect your privacy, some content in this message has been blocked. To re-enable the blocked features, click here.

To always show content from this sender, click here.

Label: DelFiveYOldEm (5 years) Expires: 6/13/2029 2:37 PM

Komentet dhe rekoman...
566 KB

Download

Caution! This message was sent from outside your organization.

E nderuara znj. Dema,

Po ju shkruajmë nga Demokraci Plus (D+), organizatë jo-qeveritare me bazë në Prishtinë.

Ju lutem gjeni të bashkangjitura komentet dhe rekomandimet e Demokraci Plus (D+) në draft strategjinë për zhvillimin dhe fuqizimin e rininë në Komunën e Drenasit, publikuar në platformën e konsultimeve publike.

Ju lutem konfirmoni pranimin e këtij e-maili dhe komenteve bashkëngjitur.

Activate Windows
Go to Settings to activate Windows.

komente 1 of 2

Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit

**Lista e pjesëmarrësve në konsultimin publik për Draft –Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e të rinjve 2024-2029**

| Nr. rendor | Emri | Mbiemri | Nr tel | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Ekrem | Franca | | |
| 2. | Dorundina | Gashi | | |
| 3. | Imer Binaku | Binaku | | |
| 4. | Lendita | Elshani | | |
| 5. | Arblinda | Murtezi | | |
| 6. | Floriana | Hasi | | |
| 7. | Learta | Mëziu | | |
| 8. | Arben | Haziri | | AHaziri |
| 9. | Arbenitë | Rama | | |
| 10 | Afrone | Qorri | | |
| 11 | Mimoza | Berisha | | |
| 12 | Fjolla | Ajderaga | | |
| 13 | Viktor | Cakolli | | |
| 14 | FATLINDA | ZYMBERI | | Zymberi |
| 15 | Edonë | Tahiraj | | |
| 16 | Aurela | Sahiti | | |
| 17 | Qëndrim | Hoxha | | |
| 18 | FATLUM | REXHAJ | | |
| 19 | Bekim | Dobra | | |
| 20. | Gentiana | Qela | | |
| 21 | Gëzim | Hajdini | | |
| 22 | Luljeta | Nebiu | | |
| 23 | Magbule | Hajdari | | |
| 24 | Sherife | Xhemajlaj | | SHxhemajlaj |
| 25 | Arizona | Ajrizaj | | |
| 26 | Bislime | Dvorani | | |
| 27 | Antigona | Bucolli | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 28 | Arlinda | Kukaj | Akukaj | |
| 29 | Shkendie | Leku | [illegible] | |
| 30 | SHEHRIJE | MUSTAFA | [illegible] | |
| 31 | ZYRAFETE | NISHORI | [illegible] | |
| 32 | QENDRESË | XHEMA | [illegible] | |
| 33 | Raltina | Gjoka | [illegible] | |
| 34 | Leonora | Shala | [illegible] | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

P.s: Ne këtë takim do të ketë edhe fotografi dhe me nënshkrimin e juaj pajtoni që fotografitë e takimit të përdoren për komunikim zyrtar.

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

**LISTA E PJESËMARRËSVE TË GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN DHE FUQIZIMIN E RINISË- DATA E TAKIMIT 18.06.2024**

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Pozita | Nr telefonit, Email-i | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Laureta Thaqi | Drejtoreshe DAP-së | laureta.thaqi@rks-gov.net | |
| 2. | Enkela Dema | Drejtoreshë e DKRS-së | enkela.dema@rks-gov.net | |
| 3. | FATLINDA ZYMBERI | ZYRTARE DAS-së ADMINISTRATIVE | fatlinda.zymberi@rks-gov.net | Zymberi |
| 4. | Arben Hazini | Këshilli i prindërve | drenimital1@gmail.com | AHazini |
| 5. | Donika Zoga | KVRL-Drenas | donika.zoga@outlook.com | |
| 6. | FATLUM REXHAJ | | fatlum.rexhaj@...t.com | |
| 7. | Rina Gashi | OJQ-Liderët e së Ardhmës | rinasgashi1@outlook.com | |
| 8. | Krenar Nika | OJQ CEDE | nika.krenar@gmail.com | |
| 9. | Lendita Elshani | Përfaqësuese Handikos Drenas | handikos.dr@hotmail.com lenditaelshani12@hi.c | |
| 10. | EKREM FRANCA | Zyrtar i Rinisë | ekrem.franca@rks-gov.net | |







Përpiluar nga:
**Fatlinda Zymberi**

Zyrtare Administrative e DKRS-së

Monitoruar nga:
**Bekim Dobra**

Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun